

RAPORT MONITORIMI

PËRHAPJA E GJUHËS SË URREJTJES DHE NARRATIVËS
EKSTREMISTE NË HAPËSIRËN DIGJITALE

Mars 2024

Projekti "Fuqizimi i Rrjetit Shqiptar të Sinjalizuesve të Besuar për të siguruar një sistem kibernetik më të sigurt kundër ekstremizmit të dhunshëm"



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania



RAPORT MONITORIMI

PËRHAPJA E GJUHËS SË URREJTJES DHE NARRATIVËS
EKSTREMISTE NË HAPËSIRËN DIGJITALE

Mars 2024

Projekti "Fuqizimi i Rrjetit Shqiptar të Sinjalizuesve të Besuar për të siguruar një sistem kibernetik më të sigurt kundër ekstremizmit të dhunshëm"



Ky studim u hartua falë bashkëpunimit me disa prej insitucioneve të sigurisë në vend. Një mirënjohje e veçantë u drejtohet të gjithë ekspertëve vendas që kanë vendosur bazat për metodologjinë e monitorimit të mesazheve ekstremiste online.



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

Botimi është pjesë e projektit “**Sinjalizues të besuar për një ekosistemin kibernetik të sigurtë ndaj ekstremizmit të dhunshëm**”, i mbështetur financiarisht nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

© Akademia e Studimeve Politike

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	6
2. ZHVILLIMET AKTUALE	7
3. METODOLOGJIA E PROCESIT TË MONITORIMIT	8
4. ANALIZA E MONITORIMIT	9
4.1 Referenca të gjetura sipas fjalëve kyçe	
4.2 Ndarja sipas gjinisë	
4.3 Antisemitizmi si fenomen i ri	
4.4 Krahasimi	
5. PËRFUNDIME	15
6. REKOMANDIME	16
SHTOJCA 1 - MOTORËT E KËRKIMIT	18
SHTOJCA 2 - FJALËT KYÇE PËR MONITORIM	20

1. HYRJE

Interneti ofron një mjedis të hapur për përhapjen e ideologjive ekstremiste dhe përmbajtjes së rrezikshme, duke përfshirë urrejtjen, diskriminimin, dhe propagandën e dhunshme. Për shkak të shpejtësisë së përcjelljes dhe lëvizjes së informacionit në platformat online, ekstremistët kanë një rrugë të lehtë për të arritur audiencën dhe për të përhapur mesazhet e tyre radikalizuese. Kjo sjellje e dëmshme mund të ndikojë në formimin e opinionit publik dhe në rritjen e rrezikut për radikalizim dhe sjellje të dhunshme në shoqëri. Prandaj, lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm në mediat sociale kërkon një përgjigje të përbashkët dhe të koordinuar nga institucionet qeveritare, shoqëria civile dhe platformat digjitale vetë për të mbrojtur përdoruesit dhe për të promovuar një ambjent më të sigurt në internet.

Për të adresuar përhapjen e këtyre mesazheve ekstremiste, agjencitë e sigurisë duhet të qëndrojnë vigjilente dhe të monitorojnë hapësirën virtuale. Për adresimin e kësaj çështje Akademia e Studimeve Politike (ASP) në bashkëpunim me “Qendrën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm” (QKEDH) dhe “Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike” (AKCESK) kanë monitoruar në një hark kohor prej katër vitesh kërcënimet e ekstremizmit të dhunshëm në hapësirën online në gjuhën shqipe.

Ky monitorim synon të ofrojë një vlerësim të mesazheve ekstremiste dhe gjuhës së urrejtjes në Shqipëri, duke nxjerrë në pah trendet e reja, identifikuar boshllëqe në kornizat ekzistuese dhe ofruar rekomandime për kundërmasa efektive.

2. ZHVILLIMET AKTUALE

Pas sulmit të dhunshëm të organizatës Hamas më 7 tetor 2023 dhe ndërhyrjes ushtarake izraelite që pasoi në Gaza, antisemitizmi global u rrit në mënyrë dramatike. Raporti i Zyrës së Diasporës Izraelite¹ zbuloi një rritje prej 235% të ngjarjeve antisemitike në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 në nivel botëror. Raportohet gjithashtu se në muajt e parë pas nisjes së konfliktit Izrael-Hamas pati një rritje prej 33% të ngjarjeve të dhunshme antisemitike.

I njëjtin trend në **narrativën antisemitike** konstatohet edhe në hapësirën online shqipfolëse në muajt e parë të konfliktit të përgjakshëm në Gaza. Monitorimi i rrjeteve kryesore sociale konstaton për herë të parë përdorimin e gjuhës së urrejtjes në mënyrë direkte ndaj popullit hebre si hakmarrje për masakrat ndaj viktimave civile në Gaza. Për fat të mirë kjo narrativë mbetet ende në nivelin e diskutimit, por shprehja në mënyrë publike në rrjetet sociale e thirrjeve për eliminimin e një popullsie, mund të rrezikojë të nxisë potencialisht sulme fizike të motivuar në baza racore ose etnike. Shfaqja e zëshme e këtyre ndjenjave antisemitike bien ndesh me traditën e bashkëekzistencës dhe tolerancës fetare shqiptare dhe kërkojnë një trajtim shumëplanësh shoqëror, përtej monitorimit të duhur nga agjencitë ligjzbatuese.

Përveç ekstremizmit fetar një tjetër fenomen shqetësues në rritje është **keqpërdorimi i hapësirës online për sulmin dhe denigrimin e të miturve dhe grave**. Statistikat zyrtare dëshmojnë se në vitin 2023 pati 765 denoncime për sulme online, përmes profileve false, shantazhimit me foto intime dhe mashtrimet². Gjithashtu, 3 raste vetëvrasjesh gajtë muajve të fundit dyshohet se patën si shkak denigrimin e figurës në rrjetet sociale.

Rritja e këtyre sjelljeve të dëmshme në platformat sociale gjatë viteve të fundit është provuar tashmë se ka nxitur konflikte të dhunshme mes të rinjve, bullizëm dhe sjellje kriminale në shkolla apo komunitete rurale. Gjuha e urrejtjes e shoqëruar me kriminalitetin juvenil janë provuar si faktorë nxitës për radikalizimin dhe krijimin e një terreni të përshtatshëm për propagandën e ekstremizmit të dhunshëm.

Monitorimi përgjatë vitit 2023 nga Rrjeti i Sinjalizuesve të Besuar³, **identifikoi “TikTok” si platformën ku fëmijët dhe të rinjtë janë më të ekspozuar** ndaj fenomeneve të padëshiruara si dhuna, gjuha e urrejtjes, pornografia, dhe ekstremizmi. Kjo kërkon një përqasje të përgjegjshme nga prindërit, shoqëria, dhe platforma për mbrojtjen e grupmoshave të rrezikuara.

Një tjetër shqetësim në rritje në hapësirën online janë **sjelljet me natyrë seksiste**. Kjo sjellje pasqyron çështje më të gjera shoqërore dhe karakterizohet nga forma të ndryshme të diskriminimit dhe objektivizimit, veçanërisht ndaj grave. Një qasje e tillë kontribuon në një kulturë që mund të dekurajojë gratë për ta parë gjininë e tyre si të përshtatshme për t'u përfshirë në politikë dhe sfera të tjera të jetës publike.

1 The Diaspora Office and World Zionist Organization - <https://www.gov.il/BlobFolder/news/news-antisemitism310124/he/antisemitism-310124.pdf>

2 Sulmet online u katërfishuan në 5 vjet - <https://faktoje.al/sulmet-online-u-katerfishuan-ne-5-vjet/>

3 Rrjeti i Sinjalizuesve të Besuar Shqiptarë: www.rsb.asp.al

3. METODOLOGJIA E PROCESIT TË MONITORIMIT

Metodologjia e përdorur në këtë monitorim përfshin një qasje holistike, duke integruar analizën njerëzore të “Rrjetit të Sinjalizuesve të Besuar” së bashku me potencialin e motorëve të kërkimit për të identifikuar dhe analizuar fjalët kyçe që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe gjuhën e urrejtjes në internet.

Më konkretisht, procesi i monitorimit pati si objektiva:

1. Kërkimi, identifikimi dhe analiza e përmbajtjeve me prirje ekstremiste në Shqipëri në platformat online (faqe interneti, blorge, rrjete sociale etj);
2. Specifikimi i platformave online të përdorura, rrjeteve sociale, ëëbsite-ve për të shpërndarë përmbajtje ekstremiste;
3. Ofrimi i statistikave të vlefshme për ndërtimin e politikave përkatëse.

Procesi i monitorimit u mbështet në metodologjinë e krijuar tashmë nga monitorimet e mëparshme, duke përfshirë studimet dhe praktikat më të mira të SHBA dhe Komisionit Evropian në këtë fushë.⁴ Bazuar mbi këto përkufizime mbi ekstremizmin e dhunshëm u zgjodh të përdoret për monitorimin metodologjia e analizës së përmbajtjes, nëpërmjet kërkimit me fjalë kyçe, që mund të çonin përdoruesit drejt përmbajtjeve ekstremiste, kur ato futen në motor kërkimi. Këto fjalë kyçe u kategorizuan bazuar në llojin e tyre ideologjik dhe rrezikun e mundshëm që lidhet me to.

(Lista e plotë e fjalëve kyçe të kërkimit dhe kategorizimi i rezultateve të gjetura mund të konsultohet në Shtojcën 2)

Për të ruajtur koherencën me raportet e mëparshme të monitorimit dhe për të lehtësuar krahasimin me vitet e mëparshme, u ripërdorur motorët “BrandMentions”, “Brand24” dhe “Social Searcher”, me anë të të cilave janë gjeneruar të dhënat lidhur me fjalët kyçe. Elementet e kërkimit u bazuan edhe në fjalët kyçe të përdorura në studimet e Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH), përse i përket përhapjes së propagandës dhe thirrjeve për ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin në Shqipëri.

Ekspertët verifikuan më tej këto të dhëna të gjeneruara në formën e linkeve, që përmbajnë fjalët kyçe dhe kanë potencial për të qenë përmbajtje të lidhura me ekstremizmin e dhunshëm, duke filtruar dhe analizuar me qëllim klasifikimin e përmbajtjes së tyre. Mbledhja dhe analizimi i të dhënave u realizua nga kërkues me eksperiencë në çështjet e monitorimit të ekstremizmit të dhunshëm si dhe komunikimit online, gjatë tre muajve në periudhën **Tetor-Dhjetor 2023**.

Për të plotësuar më tej gjetjet e këtij kërkimit, u përdorën të dhënat e monitorimit të dedikuara të rrjeteve sociale nga **Sinjalizuesit e Besuar** (Trusted Flaggers). Një grup prej 15 sinjalizuesish të trajnuar nga ASP, AKCESK dhe QKEDH mbi identifikimin e gjuhës së urrejtjes, ekstremizmit të dhunshëm dhe propagandës ekstremiste, monitorojnë prej muajit maj 2023 platformat sociale të Facebook, Instagram, X, TikTok me qëllim raportimin e përmbajtjes të dëmshme tek ofruesit e këtyre platformave. Sinjalizuesit kanë listuar në një databazë të gjitha përmbajtjet kërcënuese që janë identifikuar, mbi të cilat më pas është bërë analiza e informacioneve të mbledhura për monitorimin.

4 Website i Komisionit Evropian, Migrimi dhe Punët e Brendshme, publikim https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers_en

4. ANALIZA E MONITORIMIT

Kërkimi është përqendruar në monitorimin e platformave online (faqe interneti, blogje, rrjete sociale, etj.) të përdorura edhe nga përdoruesit shqiptarë, si Facebook, X-Twitter, YouTube, Instagram, Telegram, LinkedIn, Reddit, Vimeo, Quora, Pinterest, dhe Lojëra Online, për raste të përhapjes së propagandave apo influencimit të pikëpamjeve të caktuara me karakter ekstremist, që mund të çojnë në radikalizëm apo ekstremizëm të dhunshëm. Në fazën kur dikush ka ndjekur një hashtag apo i është bashkuar një grupi në mediat sociale, ka të ngjarë që tashmë ka treguar interes ndaj asaj ideologjie.

Nga hulumtimi u konstatua se, në Shqipëri ekzistojnë faqe të shumta web-i si dhe llogari në rrjete sociale, të cilat mund të përdoren për të përhapur ideologji ekstremiste. U vu re gjithashtu se ka llogari me emra të rremë dhe të dhëna të pasakta ose jo-publike që shpërndajnë përmbajtje me elemente të ekstremizmit në Shqipëri në gjuhën shqipe, angleze edhe arabe dhe llogari me emra të huaj që shpërndajnë përmbajtje në gjuhën shqipe, por me vendndodhje që ishte e pamundur të identifikohesh gjatë kësaj periudhe monitorimi kur bëhej analiza e secilit link të gjeneruar nga mjetet e kërkimit. Megjithatë, mjetet e kërkimit i kanë nxjerrë të gjitha të dhënat për Shqipërinë, pra nënkuptohet që vendndodhja nga ku veprojnë këta përdorues është Shqipëria. Mundësia që ofrojnë rrjetet sociale për fshehjen e të dhënave dhe anonimatin e përdoruesve krijoi vështirësi për analizimin e të dhënave dhe klasifikimin e përdoruesve në mënyrë të saktë sipas gjinisë dhe moshës.

Nga procesi i monitorimit të "Sinjalizuesve të besuar" janë kryer 439 raportime për materiale të postuara në platformat TikTok, Youtube, Facebook, Instagram, X-Twitter, Reddit, Flickr, LinkedIn, Snapchat. Platforma me më tepër raportime është platforma TikTok, (210 raportime) e cila është sot platforma më e përdorur nga brezi i ri. Në vendin e dytë është YouTube me 118 raportime. Në faqet web u identifikuan 51 linqe me përmbajtje ekstremiste. Në platformat Facebook dhe Instagram u identifikuan respektivisht 24 dhe 21 linqe. Me më pak ndikim mbeten X-Twitter (7 raportime), Reddit (5 raportime), Flickr (1 raportim), LinkedIn (1 raportim), Snapchat (1 raportim).

Nga procesi i monitorimit me anë të programeve "BrandMentions", "Brand24" dhe "Social Searcher" u gjetën përmbajtjet në të cilat përmenden fjalët kyçe që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm.

Përveç motorëve të mëparshëm të kërkimit si: "BrandMentions", "Brand24" dhe "Social Searcher", janë shtuar gjithashtu:

Kërkimi i avancuar në Google: Karakteristikat e avancuara të kërkimit të Google lejojnë përdoruesit të kufizojnë rezultatet duke përdorur fjalë kyçe, fraza dhe operatorë të veçantë. Përdoret gjerësisht për kërkime të përgjithshme në Facebook, duke përfshirë monitorimin e ekstremizmit në internet.

Kërkimi i avancuar në Bing: I ngjashëm me Google, Bing ofron opsione kërkimi të avancuara për të identifikuar rezultatet bazuar në kriteret specifike, duke përfshirë fjalë kyçe që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin.

Mjetet SOCMINT (Mjetet e Inteligjencës së Mediave Sociale): Platforma Mentionlytics që ofron mjete monitorimi të mediave sociale që mund të gjurmojnë fjalë kyçe dhe fraza që lidhen me ekstremizmin nëpër platforma të ndryshme të mediave sociale.

Nga ky monitorim u identifikuan 457 linke të gjeneruara, nga të cilat u konsideruan për analizë të detajuar linket në të cilat u gjetën përmbajtje me potencial më të lartë për t'u klasifikuar në kategoritë e mësipërme. Për pjesën tjetër të linkeve, pasi u shqyrtuan, u arrit në përfundimin se nuk kishin përmbajtje të vlefshme për monitorimin, pavarësisht se në to përmendeshin fjalët kyçe.

Bazuar në këtë monitorim të mediave sociale është ndërtuar Figura 5, e cila paraqet një grafik të shpërndarjes së linkeve sipas kategorive të përmendura më sipër, ku mbizotron gjuha seksiste, përmbajtje me narrativë terroriste, përmbajtje dhune, gjuha e urrejtjes, ekstremizmi i dhunshëm dhe bullizmi kibernetik.




Fig 5: Numri i link-eve të gjetura sipas kategorive të përmbajtjeve për rrjetet sociale

4.1 REFERENCA TË GJETURA SIPAS FJALËVE KYÇE

Nga mjetet e kërkimit online, u gjeneruan në total 457 linke, ndër to 273 linke u gjeneruan për fjalët kyçe të përgjithshme dhe 184 linke u gjeneruan për fjalë kyçe me rrezik të lart, të paraqitura në figurën 6.




Fig. 6: Numri në % i linkeve të gjetura për fjalët kyçe në total

Pas gjenerimit të këtyre linkeve, ato u analizuan dhe filtruan përmbajtjet e tyre për të përcaktuar ato që mund të klasifikoheshin si të vlefshme për të zhvilluar analizën dhe statistikat e monitorimit. Nga këto, 134 linke u gjeneruan kur u kërkua me anë të fjalëve kyçe të përgjithshme dhe 83 linke u gjeneruan kur u kërkua me anë të fjalëve kyçe me rrezik të lart.




Fig 7: Numri në % i linkeve të gjetura për fjalët kyçe pas filtrimit

4.2 NDARJA SIPAS GJINISË

Në vijim, është evidentuar se në propagandën dhe përhapjen e ideologjive ekstremiste në internet, mbi-zotërojnë kryesisht meshkujt. Në analizën e përmbajtjes së gjetur, u zbulua se shumica e propagandës dhe përmbajtjes ekstremiste është krijuar, shpërndarë ose promovuar nga llogaritë e përdoruesve, të cilët janë kryesisht meshkuj. Monitorimi tregon se 81% e përdoruesëve janë meshkuj dhe 19% janë femra. Kjo sugjeron një dominim të njëzuar të një gjinie specifike të përdoruesve të cilët janë të angazhuar në propagandën dhe përhapjen e ideologjive ekstremiste në hapësirën digjitale.




Fig 9: Gjinia e personave të përfshirë në përhapjen e përmbajtjeve të papërshtatme



4.3 ANTISEMITIZMI SI FENOMEN I RI

Një fenomen i ri i konstatuar pas muajit tetor 2023 është rritja e narrativës antisemitike nga përdoruesit e rrjeteve sociale në gjuhën shqipe. Me nisjen e ofensivës ushtarake izraelite në Gaza, në rrjetet sociale janë postuar çdo ditë foto dhe video të viktimave civile dhe fëmijëve të vrarë në Gaza, të cilat shoqërohen me thirrje kundër Izraelit dhe popullsisë hebreje. Çfarë përbën më shumë shqetësim është fakti që kjo gjuhë urrejtje shpreh në pjesën më të madhe nxitje për reagim nga shqiptarët dhe popullsitë e tjera myslimane në Lindjen e Mesme në mbrojtje të popullit palestinez.

Për të provuar këtë perceptim të narrativës antisemitike në rritje, u përdor kërkimi në dy platformat Facebook dhe Instagram të fjalëve kyçe "**zullumqarët jehud**" në postime që shoqërojnë kryesisht foto dhe video të viktimave civile në Gaza. Fjala e parë është pjesë e lutjes "Zoti i shkatërroftë zullumqarët" në terminologjinë kuranore, ku zullumi është termi për padrejtësinë si një nga mëkatet e rënda. Jehud, është emërtimi i hershëm i hebrenjve, si banorë të Judeas.

Grafikët më poshtë pasqyrojnë postimet e fjalëve kyçe të lidhura me antisemitizmin në periudhën 1 gusht 2023 – 31 mars 2024, duke krahasuar situatën e postimeve më këto fjalë kyçe para dhe pas 7 tetor 2023, nisjen e sulmit nga Hamas dhe reagimin agresiv të ushtrisë izraelite në Gaza.

Konstatohet se në platformën Facebook janë publikuar në periudhën 1 gusht – 6 tetor 2023 99 postime ose një mesatare prej 1.4 postime në ditë që përmbajnë fjalët "zullumqarë" dhe "Jehud".



Në periudhën 7 tetor 2023 – 1 mars 2024 rezultojnë 1.075 postime të tilla ose një mesatare prej 6.1 postimesh në ditë, me një rritje prej 430 përqind. Secili prej këtyre postimeve shoqërohet në shumë raste me mijëra komente me përmbajtje thirrjesh kundër popullsisë hebreje.

Situata është më serioze në platformën Instagram. Nga 0.9 postime në ditë në periudhën para nisjes së konfliktit, postimet në periudhën vijuese janë rritur me 830 përqind (7.5 postime në ditë).

Duhet theksuar se ky trend rritjeje i antisemitizmit konstatohet në nivel global si rezultat i ndërhyrjes brutale të ushtrisë izraelite dhe mijëra viktimave civile të shkaktuara në popullsinë palestineze. Por ndryshe nga vendet e tjera ku antisemitizmi ka ekzistuar më parë edhe në formatin e sulmeve të dhunshme, ky fenomen është një zhvillim i ri në hapësirën shqiptare, të njohur për bashkëekzistencën dhe tolerancën fetare dhe etnike. Shfaqja e zëshme e këtyre ndjenjave antisemitike kërkon një vëmendje të shtuar dhe trajtim shumëplanësh shoqëror për të evituar nxitjen e mëtejshme të dhunës së motivuar në baza racore dhe etnike.

4.4 KRAHASIMI

Mbi një analizë krahasuese me rezultatet e raportit të monitorimit të vitit 2022, vihet re një rritje e numrit të linkeve të gjetura në bazë të fjalëve kyçe të përgjithshme dhe me risk të lartë, e ushqyur kryesisht nga konflikti mes Izraelit dhe Hamas.

Sa i përket rezultateve të mediave sociale konstatohet se:

- Në Facebook dhe Instagram, kategoritë më të përhapura janë konstatuar linke me përmbajtje të dhunshme, gjuhë seksiste dhe urrejtje, në ndryshim nga raportet e mëparshme ku kanë mbizotëruar propaganda fetare/anti-fetare.
- Në Youtube është vënë re një rritje e lartë e numrit të linkeve të raportura që ka arritur nga 3 linke në raportin e mëparshëm, në 118 linke në monitorimin aktual, ku mbizotërojnë përmbajtje e dhunshme, gjuhë urrejtje, dhe bullizëm kibernetik.
- Në TikTok gjithashtu është vërejtur një rritje e konsiderueshme e përmbajtjeve të papërshtatshme, duke e pozicionuar TikTok si media sociale më e rrezikshme sa i përket përmbajtjeve me gjuhë seksiste, përmbajtje dhune, gjuha e urrejtjes dhe bullizmi kibernetik.
- Në X-Twitter ka pasur një rritje të lehtë të linkeve të identifikuara, të cilat përmbajnë gjuhë urrejtje dhe dhunë, në krahasim me vitin e kaluar që kanë qenë të fokusuara në propagande fetare dhe ekstremizëm islamist.

Mediat e tjera sociale dhe lojërat elektronike qëndrojnë ende një bazë e rrezikshme për shpërndarjen e përmbajtjeve të papërshtatshme në internet, megjithatë janë raportuar në numër më të vogël në platformë.

Sa i përket gjinisë së personave të përfshirë në përhapjen e përmbajtjeve të rrezikshme, vazhdojnë të mbizotërojnë meshkujt, duke thëlluar hendekun në 81%.

5. PËRFUNDIME

Përfundimet e këtij raporti identifikojnë problemet aktuale dhe kategoritë se si shfaqet ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi sot në Shqipëri. Nga ky monitorim konstatohet rritja e gjuhës së urrejtjes racore dhe fetare, përmbajtjes së dhunshme, bullizmin kibernetik dhe gjuhën seksiste, si çështjet më të hasura dhe më të prekshme në platformat sociale sot.

Analiza e gjetjeve të monitorimit tregoi se pjesa më e madhe e materialeve të gjeneruara nga motorët e kërkimit promovojnë kryesisht urrejtjen fetare (antisemitizmin) si dhe nxitje për dhunë dhe sjellje të dëmshme të të rinjve, sjellje që krijojnë premisat për ekstremizëm të dhunshëm në shoqëri.

Disa përfundime kryesore nga monitorimi janë:

- Mediat sociale si Facebook, Instagram, YouTube dhe TikTok janë mjete të përhapjes së përmbajtjeve të rrezikshme dhe ekstremiste, duke përfshirë elemente të urrejtjes, dhunës, diskriminimit, dhe propagandës së ideologjive ekstremiste.
- Kategoritë e përmbajtjeve më të përhapura online kanë ndryshuar duke u fokusuar në tema si përmbajtje e dhunshme, gjuhë urrejtje, gjuhë seksiste bullizëm kibernetik. Megjithatë, prezenca e indoktrinimit me ideologji ekstremiste që synon shtresat e marginalizuara dhe propaganda fetare mbeten fenomene të nxehta në Shqipëri.
- TikTok është konsideruar media sociale më e rrezikshme nga analiza e Sinjalizuesve të Besuar sa i përket shpërndarjes së përmbajtjeve të papërshtatshme, pavarësisht se përdoret nga vetëm 5% e popullsisë shqiptare. Numri më i madh i linkeve përmban përmbajtje diskriminuese dhe gjuhë seksiste, duke u konsideruar problemi më shqetësues për të rinjtë sot në Shqipëri, si përdoruesit kryesor të kësaj platforme.
- Youtube është përdorur gjerësisht për përhapjen dhe promovimin e përmbajtjeve të dhunshme, bullizmit kibernetik dhe gjuhës së urrejtjes.
- Nga analizimi i motorëve të kërkimit është vënë re dominimi i përdoruesve meshkuj në propagandën dhe përhapjen e ideologjive ekstremiste në hapësirën digjitale, që tregon një trend shqetësues për angazhimin e tyre në konflikte të armatosura jashtë vendit.

6. REKOMANDIME

Në botën e sotme të ndërlikuar, platformat e mediave sociale luajnë një rol kryesor në shpërndarjen e ideologjive ekstremiste, gjuhës së urrejtjes, bullizmit kibernetik, diskriminimit dhe seksizmit, duke përforcuar shtrirjen dhe ndikimin e tyre. Duke njohur urgjencën e adresimit të këtyre çështjeve, është e domosdoshme që Shqipëria të adoptojë një qasje shumëplanëshe që përfshin edukimin, angazhimin e komunitetit, kuadrin ligjor dhe bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm.

Ky grup rekomandimesh synon të ofrojë një kuadër gjithëpërfshirës për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në internet në Shqipëri, me fokus të veçantë në zbutjen e rreziqeve që lidhen me dhunën në internet, gjuhën e urrejtjes, bullizmin kibernetik, diskriminimin dhe seksizmin. Duke zbatuar këto strategji, Shqipëria mund të nxisë një mjedis digjital më të sigurt dhe më elastik që promovon tolerancën, diversitetin dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Bazuar mbi gjetjet e këtij monitorimi si dhe praktikën më të mira bashkëkohore, disa nga rekomandimet për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në hapësirën digjitale në Shqipëri, listohen si më poshtë:

- **Zhvillimi i programeve të edukimit dhe ndërgjegjësimit:**

Zbatimi i programeve të edukimit gjithëpërfshirëse, që synojnë të rinjtë për të rritur ndërgjegjësimin për rreziqet e narrativës së ekstremizmit të dhunshëm në internet, gjuhës së urrejtjes dhe radikalizimit. Këto programe duhet të fokusohen në aftësitë e të menduarit kritik, edukimin mediatik dhe qytetarinë digjitale.

- **Forcimi i kuadrit ligjor dhe zbatimit të ligjit:**

Forcimi i kornizave ligjore për të ndjekur penalisht individët që promovojnë ideologji të dhunshme në internet. Rritja e bashkëpunimit mes agjencive të zbatimit të ligjit, organave qeveritare dhe platformave të mediave sociale për të monitoruar dhe luftuar efektivisht ekstremizmin e dhunshëm.

- **Ndërveprimi me ofruesit e platformave sociale**

Rregulla më të repta në platformat e mediave sociale për të luftuar dhunën në internet, gjuhën e urrejtjes, bullizmin kibernetik, diskriminimin dhe seksizmin. Komunikimi me platformat për heqjen e përmbajtjeve ekstremiste dhe zbatimin efektiv të udhëzimeve të komunitetit. Si një praktikë bashkëkohore e Bashkimit Evropian rekomandohet transpozimi në legjislacionin vendas i “Aktit të Shërbimeve Digjitale” (Digital Service Act) si një rregullim i mëtejshëm për llogaridhënien e ofruesve të platformave si TikTok.

- **Angazhimi i Komunitetit dhe Ndërtimi i Partneritetit:**

Nxitja e partneriteteve ndërmjet agjencive qeveritare, organizatave të shoqërisë civile, institucioneve arsimore dhe kompanive në fushën e teknologjisë për të zhvilluar iniciativë të bazuara në komunitet për të luftuar radikalizimin. Angazhimi i komuniteteve lokale dhe komuniteteve fetare për të promovuar narrativa pozitive dhe për të dekurajuar ideologjitë ekstremiste.

- **Promovimi i hapësirave pozitive në internet:**

Inkurajimi i krijimit të hapësirave pozitive në internet që promovojnë tolerancën, diversitetin dhe përfshirjen. Kundërshtimi i narrativave ekstremiste përmes fushatave të mediave sociale, forumeve në internet dhe historive digjitale.

- **Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave:**

Investimi në punë kërkimore dhe mbledhjen e të dhënave për të kuptuar më mirë nxitësit dhe dinamikën e ekstremizmit të dhunshëm në internet në Shqipëri. Përdorimi i të dhënave analitike dhe mjeteve të monitorimit për të gjurmuar aktivitetet dhe tendencat ekstremiste në platformat e mediave sociale.

- **Ngritja e Kapaciteteve për Zbatimin e Ligjit dhe Edukatorët:**

Ofrimi i programeve të trajnimit dhe seminareve për zyrtarët e zbatimit të ligjit, edukatorët dhe profesionistët e tjerë të vijës së parë për identifikimin dhe reagimin ndaj radikalizimit në internet dhe gjuhës së urrejtjes.

Duke zbatuar këto rekomandime, Shqipëria mund të marrë masa proaktive për të parandaluar dhe luftuar përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm në internet, duke promovuar një mjedis online më të sigurt dhe më gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët.

SHTOJCA 1 - MOTORËT E KËRKIMIT

Mjeti i parë i kërkimit është social-searcher, nga ku gjenerohen analiza dhe statistika rreth fjalës kyçe për të cilën kërkohet. Konkretisht gjeneron përmbajtjen, sa here është përdorur fjala kyçe, tek cila faqe konkrete është përdorur dhe linkun e ridrejtimit tek ajo faqe.

URL Motorit të kërkimit: <https://www.social-searcher.com/social-buzz/?wblngw&ntww&psttypw&searchidw0&periodw&valuw&fbpagew&q5wabdullah+azzam+albania>

[Social Searcher - Free Social Media Search Engine \(social-searcher.com\)](https://www.social-searcher.com/)





Fig : Motor kërkimi për të gjeneruar analiza dhe statistika rreth fjalëve kyçe

Një mjet kërkimi tjetër është ai i Brand24, që përmes pagesës, ofron mundësinë e filtrimit të të dhënave posaçërisht për Shqipërinë, duke shkuar tek opsioni Analysis dhe zgjedhur filtrat sipas qëllimit të studimit, për shtetin që interesohemi të bëjmë monitorimin, në këtë rast Shqipëria.

https://brand24.com/?adgr=txt-brand-iv-test&keyword-ext=brand24&placement&location=9069992&gclid=CjwKCAiAk--dBhA-BEiwAchlWkXgrBeonR6lWYGK0PzwsH-9DbB6lajmr4wUodW-IVw2T4lC38eqdxoCwmIQAvD_BwE

Mjeti tjetër për kërkimin online që u përdor është BrandMentions. BrandMentions gjeneron të dhëna sa herë është përmendur një fjalë kyçe, duke monitoruar në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze, për shtetin që interesohemi të bëjmë monitorimin, në këtë rast Shqipëria, jep linket ku është përdorur si dhe mundëson raporte të detajuara për secilën fjalë kyçe.



The screenshot shows a configuration window titled 'What metrics do you want to view?'. It contains a grid of 10 metric options, each with a checkbox:

- mentions (checked)
- interactions (checked)
- reach (checked)
- shares (checked)
- likes (checked)
- social mentions (unchecked)
- web mentions (unchecked)
- backlinks (unchecked)
- positive mentions (unchecked)
- negative mentions (unchecked)

At the bottom, there are three buttons: 'APPLY', 'CANCEL', and 'RESET TO DEFAULT'.

SHTOJCA 2 - FJALËT KYÇE PËR MONITORIM

Kategoritë e përcaktuara për klasifikimin e përmbajtjeve janë: dezinformimi, diskriminimi fetar, propaganda fetare, propaganda anti-fetare, gjuhë e urrejtjes, ekstremizmi politik që përfshin ekstremizmin politik të të majtës ekstreme dhe ekstremizmin politik të të djathtës ekstreme, përmbajtje lidhur me konfliktin etnik dhe luftën etnike, implikime ekstremistësh dhe terroristësh, ekstremizmi islamist, teoritë konspirative, antisemitizmi, dezinformimi, përmbajtje të tjera ekstremiste, përmbajtje neutrale dhe përmbajtje fetare. Për secilën nga këto fjalë kyçe, u konstatua numri i personave ose llogarive që propagandojnë ideologji ekstremiste, përfshirë këtu edhe ekstremizmin etnik, politik etj.

Kategorizimi i Fjalëve Kyçe⁵

Kategorizimi i fjalëve kyçe ishte ruajtur i njëjtë me kategorizimin e vitit të kaluar për të krijuar një metodë të qëndrueshme krahasimi për identifikimin e përmbajtjes së dyshimtë në internet.

Për të identifikuar nivelin e rrezikut të lidhur me secilën fjalë në përmbajtjen ku bëjnë pjesë, fjalët kyçe u ndanë në kategoritë:

- Kategoria 1: Fjalë ekstreme, të dhunshme
- Kategoria 2: Fjalë kyçe të përgjithshme

Kategorizimi i fjalëve kyçe të tilla si “vrasja e të pabesëve” ose “vrasja e apostateve” janë në thelb me përmbajtje të dhunshme, ndërsa të tjerat, siç janë ‘kryqëzatat’ ose ‘kalifati’ janë më të përgjithshme në natyrën e tyre, për këtë arsye përmbajtja e tyre duhej të analizohet me kujdes, me qëllim që të mos ndikonte të drejtën e lirisë së fjalës, mendimit, dhe të besimit.⁶

Fjalë kyçe me risk të lartë	Fjalë kyçe të përgjithshme
Jelek vetëvrasësi	Dëshmor
Vrasja e apostujve	Xhihad

Tabela nr.1: Kategorizimi i fjalëve kyçe

Midis kategorive ishte e pashmangshme mbivendosja, megjithatë përcaktimi pasqyroi vetëm natyrën e fjalës dhe jo lidhjet e saj me ndonjë grup të veçantë. Kjo do të thotë që koncepti i “khilafah” është më i lidhur me ISIS-in, por vetë fjala nuk ka domethënie të dhunshme apo ekstreme. Si rezultat, ajo u kategorizua në listën e fjalëve politike islamike.

Përhapja e Fjalëve Kyçe

Të dhënat për përdorimin e fjalëve kyçe, u siguruan duke iu drejtuar mjeteve online të kërkimit⁷, ku nëpërmjet të dhënave historike, u filtruan rezultatet specifike me përmbajtje lidhur me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

⁵ Shtojca 2, fjalët kyçe për monitorim

⁶ EU Human Rights Guidelines on Freedom of Expression Online and Offline <https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/142549.pdf>

⁷ Shtojca 1, Motorët e kërkimit

Megënëse monitorimi nuk kishte qasje në të gjitha të dhënat historike që mund të ekzistojnë në internet për platformat/rrjetet e monitoruara, përqindjet e numrit të linkeve të gjeneruara për fjalët kyçe të cilat përmenden në to, mund të përdoret si një udhëzues i dobishëm për popullaritetin e fjalëve të përdorura në internet, por nuk japin shifra përfundimtare.

Frekuencat lokale u mbledhën për të gjitha fjalët kyçe duke zgjedhur si opsion tek mjetet e monitorimit filtrin që gjeneronte linket ku përmenden këto fjalë sipas shteteve, në rastin konkret për Shqipërinë. Të dhënat për frekuencat e fjalëve arabe nuk korrespondojnë ekskluzivisht me zonën gjeografike arabe, por arsyetimi për të zgjedhur fjalët kyçe në gjuhën arabe dhe zhvilluar monitorim për përmbajtje në këtë gjuhë, vjen nga fakti se, është gjuha e përdorur nga grupime të ndryshme ekstremiste pa dallim kufinjsh. Gjatë analizës së të dhënave, u identifikuan llogaritë si dhe personat, kur ishte e mundur, të cilët ishin aktivë në faqet e internetit, mediat sociale, youtube, ku gjendeshin fjalët kyçe, si dhe u nxorën statistika mbi gjininë e tyre dhe kategoritë e përmbajtjeve që ata përhapin.

Kategorizimi i përmbajtjes

Kategorizimi i përmbajtjes u krijua për të pasur një pasqyrë më të detajuar të llojit të përmbajtjes ku gjenden fjalët kyçe të analizuara. Përcaktime të përmbajtjes së gjetur në një ëbsite nuk pasqyronte gjykimin për një faqe të tërë, por vetëm të përmbajtjes ku ndodhej fjala kyçe.

Kategoritë	Ekstreme	Neutrale	Anti-fetare
1	Të dhunshme		
2	Jo të dhunshme		
3	Politike Islamike		
4		Lajme, Analizime, Ideologji fetare	
5		Shoqëria Civile	
6		Qeveritare	
7		Grupe Fetare	
8			Anti-islamike, anti-krishterim, etj

Tabela nr.2: Kategorizimi i përmbajtjeve ku gjenden fjalët kyçe

Grupimi mbi përmbajtjen ekstreme u nda në tre nën-kategori; i dhunshëm, jo i dhunshëm dhe përmbajtje politike radikale të grupeve terroriste. Përmbajtjet u kategorizuan si të dhunshme nëse ato përmbanin imazhe grafike të dhunës ose nxitje të dhunës.

Përmbajtjet që u vlerësuan të jenë ekstreme, por jo të dhunshme ishin ato që shprehnin pikëpamje antisemite, homofobike, raciste ose sektare, por pa nxitur dhunën. Kategoria përmbajtje politike radikale përfshinte përmbajtje, të cilat shprehnin një prirje specifike ndaj një grupi të veçantë islamik. Kjo kategori në mënyrë të qartë iu referua grupeve të njohura politike, që janë duke kërkuar në mënyrë aktive për të fituar pushtet politik.

Grupimi mbi përmbajtjet neutrale përfshin ëbfaqet kryesore të mediave, faqet e internetit, të cilat përhapin ideologji fetare, si dhe përmbajtjet e prodhuara dhe/ose shpërndara nga grupet e shoqërisë civile, grupet qeveritare dhe grupet fetare. Për grupet fetare, kjo përfshin organizata të njohura fetare, si dhe individë me prirje islamike, të cilët përhapin ideologji mbi besimin e tyre.

Grupimi mbi përmbajtjen anti-fetare përfshin disa fjalë kyçe ku ekziston prania e vazhdueshme e informacionit me përmbajtje ekstremiste kundër besimeve fetare të tilla si mysliman, të krishterë dhe besimeve të tjera.

FJALËT KYÇE PËR MONITORIM TË PËRGJITHSHËM

Apostasy	Apostate	Ayman al-Zawahiri
Caliphate	Crusader	Crusaders
Dabiq	Dabiq Magazine	Ibn Taymiyyah
Islamic State	Jihad	Jihad Meaning
Kafir	Khalifa Meaning	Khilafah
Kuffar	Martyr	Martyrdom in Islam
Martyrs	Mujahideen	Shahada
Suicide Vest	Hebre	Jehud
Zullumqar		

FJALËT KYÇE PËR MONITORIM ME RISK TË LARTË

Abdullah Azzam	Amaq Agency	Apostate Islam
Apostates in Islam	Beheadings	Crusader Army
Crusaders Against Islam	Dabiq PDF	How to do Jihad
Ibn Taymiyyah Jihad	Inspire Magazine	Kabbalah
Cabala	Cabbala	Cabbalah
Jewish Coalition	Jihad for Ummah	Jihad in the Quran
Khalifah	Khilafah Syria	Killing Apostates

Killing Infidels	Killing Kuffar	Mujahid
Preparing for Jihad	Rafidah	Soldiers of the Caliphate
Taghut	Amelije Istishadije	Al-Qaeda
Bidatci	Dawla Islamiyyah	Eksploziv
Emir	Ekstremizëm	Haku
Hawala	Hixhara	Ikhuani
Khalifat	LHT	Muxhahid
Muvahid	Murtedat	Munafik
Murxhi	Rafidijte	Shehid
Sherihat	ISIL	ISIS
Shtet Islamik (Khalifat)	Shirk	Targut
Tekfir	Kabala	Plandemi
Kaur		

RAPORT MONITORIMI

PËRHAPJA E GJUHËS SË URREJTJES DHE NARRATIVËS
EKSTREMISTE NË HAPËSIRËN DIGJITALE

Mars 2024



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

